

|                                                                                                                                    |                 |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës<br>Komora inženjera Republike Kosovo<br>Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo |                 |
| Njësia org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit                                                                                          | <b>OIRK</b>     |
| Nr. i taqesve<br>Br. Stranica<br>Nr. Pages                                                                                         | <b>1</b>        |
| Nr. i Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No.                                                                                             | <b>28/26</b>    |
| Data:<br>Datum:<br>Date:                                                                                                           | <b>19.01.26</b> |
| <b>PRISHTINË / A</b>                                                                                                               |                 |

## MARRËVESHJE PËR SPONSORIZIM

për mbështetje në organizimin e Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së

E lidhur në Prishtinë, më 19.01.2026, ndërmjet:

**1. Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)**, me numër fiskal 603383324 me seli në Prishtinë, (në vijim: "OIRK"), e përfaqësuar nga **Kryetari, z. Arsim Rapuca**, dhe

**2. Construmax sh.p.k.**, me NUI 811273739, kompani private ndërtimore, (në vijim: "Sponsoruesi"), e përfaqësuar nga **Drejtori, z. Faton Krasniqi**,

bashkërisht në vijim: "Palët".

### Neni 1. Qëllimi i Marrëveshjes

1.1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është sponsorizimi (donacioni në natyrë) nga Sponsoruesi për mbështetje të shpenzimeve logjistike për organizimin e **Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së** (në vijim: "Ngjarja").

1.2. Ngjarja do të mbahet më datë 07 shkurt 2026, në Hotel Emerald, Salla "Beethoven", Prishtinë.

1.3. Sponsorizimi bëhet ekskluzivisht për mbulimin e kostove të ofertës së **Emerald Hotel**.

### Neni 2. Përshkrimi i sponsorizimit dhe vlera

2.1. Sponsoruesi merr përsipër të mbulojë shpenzimet sipas ofertës së Emerald Hotel, për rreth 600 persona prezent, si vijon:

- Salla: 800 €
- Kafe ose çaj me një shishe ujë: 1,680 €
- LED ekrani: 1,500 €

**Totali: 3,980 €.**

2.2. Nëse ofruesi i shërbimit (Emerald Hotel) faturon ndryshime të arsyeshme për shkak të numrit final të pjesëmarrësve apo ndryshimeve teknike, Palët do të koordinohen paraprakisht dhe çdo pagesë shtesë do të bëhet vetëm me **pëlqim me shkrim** të të dy Palëve.

### Neni 3. Mënyra e realizimit të sponsorizimit (pagesa direkte)

3.1. Sponsoruesi do t'i kryejë pagesat **drejtpërdrejt te Emerald Hotel** (ose te ofruesit e shërbimeve të përfshirë në ofertë, në rast se faturimi bëhet veçmas).

3.2. **OIRK nuk pranon mjete financiare** nga Sponsoruesi dhe nuk administron transferta monetare lidhur me këtë sponsorizim.

3.3. Sponsoruesi i siguron OIRK-së **kopjet e faturave dhe/ose konfirmimet e pagesës** për qëllime dokumentimi dhe arkivimi institucional.

#### **Neni 4. Pa kushte – pa ndikim – pa përfitime**

4.1. Sponsorizimi është **donacion pa kushte** dhe nuk krijon asnjë detyrim të OIRK-së për dhënie të favorizimeve, rekomandimeve, apo trajtimi preferencial ndaj Sponsoruesit.

4.2. Sponsoruesi nuk ka dhe nuk do të ketë **asnjë rol** në organizimin institucional, përmbajtjen e Agjendës, vendimmarrjen, votimet, zgjedhjet apo çfarëdo vendimi të organeve të OIRK-së.

4.3. Kjo Marrëveshje nuk ndikon dhe nuk mund të interpretohet si ndikim në asnjë proces licencimi, regjistrimi, vlerësimi profesional, procedurë disiplinore apo vendimmarrje të OIRK-së.

#### **Neni 5. Mirënjohja dhe hapësira promovuese (Sponsor logjistik)**

5.1. OIRK do ta paraqes Sponsoruesin si:

“Sponsor logjistik i Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së”, me formë të kufizuar dhe të kontrolluar të ekspozimit publik.

5.2. Në kuadër të mirënjohjes për mbështetjen logjistike, OIRK do të mundësojë këto forma promovimi:

a) **Slide falënderimi** në prezantimin zyrtar (në fillim ose në fund), me tekst:

“Sponsor logjistik: Construmax sh.p.k.” dhe me logo;

b) **Vendosje e një roll-up/banner-i** të Sponsoruesit në hapësirën e hyrjes/pritjes, pa penguar funksionimin e Ngjarjes;

c) **Përmendje verbale** në fjalën hapëse të Kryetarit (maksimum 10–15 sekonda), si falënderim për mbështetjen logjistike.

5.3. Ekspozimi i lartcekur është **i kufizuar** dhe nuk nënkupton partneritet institucional, rol vendimmarrës, apo mbështetje të veçantë të OIRK-së ndaj Sponsoruesit.

#### **Neni 6. Përdorimi i emrit dhe logos së OIRK-së nga Sponsoruesi**

6.1. Sponsoruesi mund ta përdorë emrin/logon e OIRK-së vetëm për qëllime të komunikimit të sponsorizimit të kësaj Ngjarjeje, me formulim të qartë:

“Sponsor logjistik i Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së”.

6.2. Sponsoruesi nuk guxon të përdorë emrin/logon e OIRK-së në mënyrë që krijon përshtypjen e “partneritetit institucional”, “përfaqësimit”, “miratimit”, apo ndikimit në vendimmarrjen e Odës.



## Neni 7. Afati dhe përfundimi

7.1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e Palëve dhe vlen deri në përfundimin e Ngjarjes dhe kompletimin e dokumentacionit të pagesave.

7.2. Në rast të anulimit të Ngjarjes, Palët do të koordinohen me Emerald Hotel për trajtimin e kostove eventuale të anulimit sipas kushteve të hotelit.

## Neni 8. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

8.1. Palët angazhohen që çdo mosmarrëveshje ta zgjidhin me mirëkuptim dhe komunikim zyrtar.

8.2. Nëse nuk arrihet zgjidhje, kompetente janë gjykatat përkatëse në Prishtinë, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

## Neni 9. Dispozita përfundimtare

9.1. Kjo Marrëveshje përbëhet nga **3 faqe** dhe nënshkruhet në **dy (2) kopje origjinale**, nga një për secilën Palë.

9.2. Çdo ndryshim/plotësim i kësaj Marrëveshjeje bëhet vetëm me **Aneks me shkrim**, të nënshkruar nga të dy Palët.

## NËNSHKRIMET

Për OIRK

Kryetar

Arsim Rapuca



Për Construmax sh.p.k.

Drejtör

Faton Krsniqi



Data: 19.01.2026

Vendi: Prishtinë